

Vendim nr. 212, datë 25.06.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Marjana Semini,	Anëtare
Asim Vokshi,	Anëtar

në datën 25.06.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 32 (A) 2026 të Regjistrat Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **APOSTOL (PIRO) BUCAJ**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 187, datë 07.10.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. 224, datë 12.12.2022 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2025-1536, datë 14.10.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, duke urdhëruar pranimin dhe shqyrtimin në themel të kërkesës për shuarjen e dënimit të dhënë nga autoritetet greke dhe heqjen e tij nga regjistrat penalë dhe të kërimit ndërkombëtar.

Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të subjektit të interesuar.

BAZA LIGJORE: **Nenet 17, 18, 27, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 132 dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Nenet 5, 6, 7 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe**

funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (Ligji Organik i Gjykatës).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Asim Vokshi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë ka paraqitur kërkesë për shuarjen e dënimit penal të kërkuarit. Rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 05, datë 24.11.2008, ka vendosur njohjen e vendimit penal nr. 167-181, datë 13.11.1995 të Gjykatës së Përzier të të Betuarve të Pireut; konvertimin e dënimit të dhënë ndaj kërkuarit, duke e dënuar me njëzet e pesë vjet burgim për veprën penale “Vrasja me paramendim”, të parashikuar nga neni 78, paragrafi 1, i Kodit Penal (*KP*); dënimin e kërkuarit me 1 vit burgim edhe për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta”, si dhe caktimin e një dënimi të vetëm duke e dënuar përfundimisht me 25 vjet burgim.

2. Kërkuari ka vuajtur në Greqi dënimin e dhënë ndaj tij, për rrjedhojë autoritetet greke të drejtësisë kanë refuzuar ekstradimin e tij për në Shqipëri. Po kështu, rezulton se me vendimin nr.110, datë 05.06.2020 të Këshillit të Gjykatës së Kundërvajtjeve, Kalkidhiki ndaj kërkuarit është vendosur lirimi me kusht për pjesën e pavuajtur të dënimit, pasi vendimi nr. 167-181, datë 13.11.1995 i Gjykatës së Përzier të të Betuarve të Pireut është ekzekutuar nga autoritetet greke të drejtësisë. Nisur nga ky fakt, kërkuari ka pretenduar se e ka vuajtur dënimin e dhënë, ndaj duhej konstatuar shuarja e tij.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 187, datë 07.10.2022, ka vendosur deklarimin të papranueshme të kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me objekt “Shuarje e dënimit penal” për kërkuarin, me arsyetimin se ai ishte dënuar nga gjykata e shtetit grek dhe vendimi ishte vënë në ekzekutim po në këtë shtet. Ndërsa në shtetin shqiptar nuk rezultonte që kërkuari të ishte evidentuar si i dënuar, si dhe subjekt (i dënuar) që ishte në procedurë ekzekutimi vendim dënimi për të. Sipas gjykatës, vetë prokurori në kërkesë shprehet se kërkuari ka vuajtur në Greqi dënimin e dhënë ndaj tij, për rrjedhojë autoritetet greke të drejtësisë kanë refuzuar ekstradimin e tij për në Shqipëri. Pra, duke mos pasur në shtetin shqiptar vendim në

ekzekutim për kërkuesin, ky vendim është në ekzekutim po në shtetin grek, është gjykata e këtij shteti, ajo që duhet të shprehet për shuarjen e dënimit ose jo, ku kërkuesi është i evidentuar si subjekt i dënuar. Vendimi nr. 05, datë 24.11.2008 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për konvertimin e dënimit, nuk është vënë dhe nuk mund të vihet në ekzekutim, përderisa është refuzuar ekstradimi i kërkuesit. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim mbrojtësi i kërkuesit, duke kërkuar pranimin e kërkesës së organit të akuzës, pushimin e ndjekjes penale dhe heqjen nga sistemi i kërkimit kombëtar dhe ndërkombëtar, për sa i përket dënimit të cilin e ka shlyer në shtetin grek.

4. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 224, datë 12.12.2022, ka vendosur mospranimin e ankimit, me argumentin se mbrojtësi i kërkuesit nuk legjitimohej në paraqitjen e tij, pasi edhe pse ai ishte i zgjedhur me prokurë të posaçme nga familjarët, në të tilla gjykime nuk mund të shprehte vullnetin mbrojtësi në mungesë të vet personit ndaj të cilit shtrin efektet kërkesa në fjalë. Sipas kësaj gjykate, nuk rezulton që mbrojtësi të ketë pasur komunikime me kërkuesin dhe të ketë marrë pëlqimin e këtij të fundit për të proceduar me ankim ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë në mungesë të tij. Prokura e posaçme mbi të cilën ka vepruar mbrojtësi, duke pretenduar se ka tagra përfaqësimi, rezulton se është lëshuar nga familjarët e kërkuesit dhe jo personalisht prej tij. Gjithashtu, kjo gjykatë i është referuar vendimit unifikues nr.1, datë 10.03.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit në qoftë se i pandehuri nuk është fizikisht i paraburgosur dhe nuk ka prova të mjaftueshme për të besuar se ka njohuri për procesin penal në ngarkim të tij, atëherë zgjedhja e mbrojtësit nga ana e të afërmeve të të pandehurit të gjykuar në mungesë do të konsiderohet, për efekt të ligjit procedural, si mbrojtës i caktuar kryesisht. Pra, mbrojtësi i zgjedhur nga familjarët do të pranohet nga gjykata duke e legjitimuar, por duke i njohur tagrat e mbrojtësit të caktuar, që janë të drejtat procedurale që ka mbrojtësi në procesin penal, me përjashtim të të drejtave që ligji ia njeh si të drejta ekskluzivisht personale të pandehurit. Në përfundim, kjo gjykatë ka vlerësuar se e drejta për të bërë ankim, në vështirësi të përcaktimit ligjor të bërë nga ligjvënësi në nenet 50, pika 1 e 410 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), është një e drejtë e cila i rezervohet personalisht të pandehurit. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1536, datë 14.10.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 432 të KPP-së. Sipas këtij kolegji, gjykata e apelit ka arsyetuar mjaftueshëm/drejt disponimin e saj për mospranimin e ankimit, si ankimi i paraqitur nga personi i

palegjitimuar, pasi mosplotësimi i kushteve proceduralo - formale të ankimit (apelit), si parakusht procedural, passjell mosshqyrtimin në lëndë të ankimit nga gjykata dhe, për pasojë, disponimin për mospranimin e ankimit. Kolegji Penal ka evidentuar se nga aktet në dosje rezulton që mbrojtësi që ka paraqitur apel/ankim në emër të kërkuesit nuk ka marrë pëlqimin e këtij të fundit për të proceduar me ankim ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë të dhënë në mungesë të tij, duke gjetur të drejtë arsyetimin e vendimit të gjykatës së apelit. Në përfundim, ky kolegji ka vlerësuar se gjykatat më të ulëta kanë kryer një proces gjyqësor në konformitet me parimet bazë të procesit penal dhe në vendimmarrje (objekt rekursi) nuk konstatohen shkelje që kanë të bëjnë me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material ose procedural, me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit procedural, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave dhe vendimi i ankimuar nuk vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

6. Në datën 23.04.2026 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuesit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet objekt kundërshtimi kanë cenuar:

7.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

7.1.1. *Së drejtës së aksesit*, pasi gjykatat kanë refuzuar të shqyrtojnë ankimin bazuar në një interpretim të gabuar të vendimit unifikues nr. 1/2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si dhe nuk kanë zhvilluar asnjë hetim për të verifikuar mungesën e vullnetit të kërkuesit në prokurën e nënshkruar nga familjarët. Gjykata e Apelit ka mohuar legjitimitetin e mbrojtësit të zgjedhur me prokurë të posaçme nga familjarët, në kundërshtim me standardet e GJEDNJ-së. Po kështu, gjykatat nuk kanë marrë parasysh faktin se kërkesa fillestare erdhi nga prokuroria (me letërporosi nga shteti grek), duke krijuar një pengesë artificiale për kërkuesin, i cili nuk mund të ishte fizikisht i pranishëm, për shkak të

vuajtjes së dënimit jashtë. Ai ka kërkuar shuarjen e dënimit për vendimin e gjykatës e cila ka njohur vendimin e huaj, vendim i cili është procedural dhe jo vendim themeli. Për këto shkaqe kërkuar i janë cenuar edhe *e drejta e mbrojtjes dhe ankimit efektiv, e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, e drejta për t'u dëgjuar si dhe parimi i barazisë së armëve.*

7.1.2. *Parimit të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit*, pasi gjykatat kanë refuzuar të shqyrtojnë në themel provat dhe dokumentet e paraqitura si dhe kërkesën për shuarjen e dënimit, duke u bazuar vetëm në formalitete procedurale dhe duke e mbajtur kërkuar në sistemin e kërimit ndërkombëtar pa bazë ligjore dhe ndaj tij vazhdon statusi si i dënuar në shtetin shqiptar. Në këtë mënyrë kërkuar është në pamundësi për të hequr pasojat e një vendimi penal të ekzekutuar në Greqi dhe i mohohet lëvizja e lirë dhe pajisja me dokumente identifikimi nga shteti shqiptar.

7.2. *Parimin e barazisë përpara ligjit*, pasi gjykatat e kanë trajtuar kërkuar në mënyrë diskriminuese, duke aplikuar një standard të rreptë për legjitimitimin e mbrojtësit vetëm sepse ai e ka vuajtur dënimin jashtë Shqipërisë. Në raste të ngjashme, për njohje të vendimeve të huaja, ankimi lejohet edhe me përfaqësim nga të afërmit. Kërkuar kishte pritshmëri të ligjshme që ligji do të zbatohet njësoj edhe për të. Prokuroria nuk u pengua në gjykim, në ndryshim nga kërkuar, i cili u privua nga e drejta për të mbrojtur interesat e tij.

7.3. *Lirinë personale në drejtim të parimit të proporcionalitetit*, pasi refuzimi i shuarjes së dënimit pa shqyrtuar themelin e çështjes mban në fuqi një regjistër penal për kërkuar, duke cenuar lirinë e tij. Kërkuar e ka vuajtur dënimin e tij të plotë në Greqi dhe refuzimi i shuarjes është arbitrar dhe kthehet në një dënim të përhershëm administrativ.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuar

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitetit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuuesit. Mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kriterëve, me pasojë moskalimin e saj në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit kriter që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

10. Në rastin konkret, për sa i takon legjitimitetit *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, në drejtim të së drejtës së aksesit, së drejtës së mbrojtjes dhe ankimit efektiv, së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, së drejtës për t’u dëgjuar dhe parimit të barazisë së armëve, parimit të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsyetimit si dhe parimit të barazisë përpara ligjit dhe lirisë personale në drejtim të parimit të proporcionalitetit.

11. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, kërkuuesi ka pretenduar se gjykatat e kanë trajtuar kërkuuesin në mënyrë diskriminuese, duke aplikuar një standard të rreptë për legjitimitetin e mbrojtësit vetëm sepse ai e ka vuajtur dënimin jashtë Shqipërisë. Sipas tij, në raste të ngjashme, për njohje të vendimeve të huaja, ankimi lejohet edhe me përfaqësim nga të afërmit.

12. Lidhur me këtë pretendim, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se kur kërkuuesit kanë pretenduar cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit në lidhje me mënyrën sesi gjykatat kanë

vendosur në raste të ngjashme, atëherë vlerësimi kushtetues i mënyrës së zgjidhjes së çështjeve të ngjashme nga gjykatat e zakonshme bëhet duke verifikuar rrethanat e rastit konkret. Fakti që gjykatat e zakonshme kanë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, në vetvete nuk mund të justifikojë *a priori* pretendimet e individit, pasi mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, për sa kohë çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, harmonizuar edhe me rrethana, faktorë, motive ose prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë të njëjta (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 17, datë 23.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në këtë standard, në rastin konkret, Kolegji vlerëson se argumentet e kërkuarit janë me natyrë të përgjithshme dhe ai nuk ka referuar ndonjë vendim unifikues ose njësesues të detyrueshëm për zbatim nga ana e gjykatave. Gjithashtu, vetëm fakti që gjykatat mund të kenë vendosur ndryshe në raste të ngjashme në dukje, por që kanë specifikat e tyre, nuk përbën argument që do të çonte në cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit, për rrjedhojë ky pretendim i kërkuarit është haptazi i pabazuar.

13. Kolegji vëren gjithashtu se kërkuari ka pretenduar cenimin e *lirisë personale në drejtim të parimit të proporcionalitetit*, pasi refuzimi i shuarjes së dënimit pa shqyrtuar themelin e çështjes mban në fuqi një regjistër penal për kërkuarin, duke cenuar lirinë e tij. Ai ka pretenduar se e ka vuajtur dënimin e tij të plotë në Greqi dhe refuzimi i shuarjes është arbitrar dhe kthehet në një dënim të përhershëm administrativ. Po kështu, kërkuari ka pretenduar edhe cenimin e *së drejtës së aksesit*, me argumentin se gjykatat kanë refuzuar të shqyrtojnë ankimin bazuar në një interpretim të gabuar të vendimit unifikues nr. 1/2011, si dhe nuk kanë zhvilluar asnjë hetim për të verifikuar mungesën e vullnetit të kërkuarit në prokurën e nënshkruar nga familjarët. Ai ka pretenduar se ka kërkuar shuarjen e dënimit për vendimin e gjykatës, e cila ka njohur vendimin e huaj, vendim i cili është procedural dhe jo vendim themeli. Për këto shkaqe, kërkuari ka evidentuar edhe cenimin e *së drejtës së mbrojtjes dhe ankimit efektiv, së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe së drejtës për t'u dëgjuar*, si dhe *parimit të barazisë së armëve*. Kërkuari ka pretenduar edhe cenimin e *parimit të sigurisë juridike* të lidhur me *standardin e arsyetimit të vendimit*, pasi gjykatat kanë refuzuar të shqyrtojnë në themel provat dhe dokumentet e paraqitura, si dhe kërkesën për shuarjen e dënimit, duke u bazuar vetëm në formalitete procedurale dhe duke e mbajtur kërkuarin në sistemin e kerkimit ndërkombëtar pa bazë ligjore, pasi ndaj tij vazhdon statusi si i dënuar në shtetin shqiptar.

14. Nisur nga thelbi dhe përmbajtja e këtyre pretendimeve, Kolegji vlerëson që ato do të analizohen në drejtim të *së drejtës së aksesit të lidhur me ankimin efektiv dhe standardin e*

arsyetimit të vendimit, për sa kohë ato lidhen me qëndrimin e gjykatës së apelit dhe Gjykatës së Lartë për mospranimin e ankimit të bërë nga mbrojtësi i zgjedhur nga familjarët dhe në vijim mospranimin e rekursit.

15. Në nenin 42, pika 2, të Kushtetutës parashikohet se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e gjykimit të drejtë dhe publik brenda afatit të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, përfshirë të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik (*shih vendimet nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 10, datë 12.04.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). E drejta e ankimit është vlerësuar si mundësi e çdo individit për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar atij (individit) të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj. Në funksion të ushtrimit efektiv të së drejtës së ankimit ka rëndësi të realizohet si aspekti formal/procedural, ashtu edhe ai substancial. Kërkesat procedurale të ankimit janë, para së gjithash, në funksion të aksesit që duhet të kenë individët për të ushtruar efektivisht ankimin ndaj vendimit gjyqësor. Çdo instancë ankimuese që njeh sistemi i normave procedurale civile /penale është pjesë e së drejtës së individit për të pasur akses në gjykatë (*shih vendimet nr. 23, datë 25.04.2023; nr. 24, datë 25.04.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Sipas Gjykatës, e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. E thënë ndryshe, Gjykata vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 25, datë 23.04.2025; nr. 67, datë 06.12.2023; nr. 59, datë 14.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin konkret, nga aktet bashkëlidhur ankimit kushtetues, Kolegji konstaton se kërkuesi është dënuar nga një gjykatë e shtetit grek për kryerjen e disa veprave penale, vendim i cili është njohur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr. 05, datë 24.11.2008. Kërkuesi e ka vuajtur dënimin në shtetin grek dhe me vendimin e datës 05.06.2020 është vendosur lirimi i tij me kusht. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë i është drejtuar kësaj gjykate me kërkesë për shuarjen e dënimit, me argumentin se në kushtet kur vendimi i dënimit të dhënë ndaj kërkuesit është ekzekutuar dhe ai e ka vuajtur dënimin, duhet të konstatohet shuarja e dënimit të dhënë me vendimin nr. 05, datë 24.11.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

18. Me vendimin nr. 187, datë 07.10.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë e ka deklaruar të papranueshme këtë kërkesë, me arsyetimin se për sa kohë nuk rezulton që kërkuesi të jetë i dënuar ose në procedurë ekzekutimi të vendimit të dënimit në shtetin shqiptar, është gjykata e shtetit grek ajo që duhet të shprehet për shuarjen e dënimit ose jo. Po sipas kësaj gjykate, për sa kohë është refuzuar ekstradimi i kërkuesit, vendimi nr. 05, datë 24.11.2008 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për konvertimin e dënimit, nuk është vënë dhe nuk mund të vihet në ekzekutim. Kundër këtij vendimi rezulton të jetë bërë ankim nga mbrojtësi i caktuar me prokurë nga familjarët e kërkuesit, konkretisht vëllai i tij.

19. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 224, datë 12.12.2022, ka vendosur mospranimin e ankimit, duke mos e legjitimuar mbrojtësin e caktuar nga familjarët, duke iu referuar neneve 50 dhe 410 të KPP-së. Sipas kësaj gjykate, nuk rezulton që mbrojtësi të ketë pasur komunikime me kërkuesin dhe të ketë marrë pëlqimin e këtij të fundit për të proceduar me ankim ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë në mungesë të tij. Në referim të vendimit unifikues nr. 1/2011 dhe dispozitave procedurale penale, gjykata e apelit ka vlerësuar se e drejta e ankimit i rezervohet personalisht kërkuesit. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

20. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1536, datë 14.10.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 432 të KPP-së. Ky kolegji ka vlerësuar të drejtë arsyetimin e vendimit të gjykatës së apelit për sa i përket moslegjitimit të mbrojtësit në paraqitjen e ankimit, duke u mbështetur në jurisprudencën kushtetuese dhe vendimet unifikuese nr. 1/2011 dhe nr.1/2014.

21. Nga ana tjetër, Kolegji Penal ka vlerësuar se gjykatat më të ulëta kanë kryer një proces gjyqësor në konformitet me parimet bazë të procesit penal dhe nuk konstatohen shkelje që kanë të bëjnë me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material ose procedural, me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit

procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave dhe vendimi i ankimuar nuk vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

22. Për sa i përket së drejtës së ankimit të të gjykuarit në mungesë, Gjykata është shprehur se e drejta e të pandehurit për të marrë pjesë në gjykim, si dhe për të zgjedhur përfaqësuesit ligjorë është një e drejtë kushtetuese vetjake, e cila nuk mund të transferohet te familjarët. Parashikimi në KPP për mundësinë e familjarëve për të pajisur me prokurë mbrojtësin e të pandehurit nuk nënkupton transferimin e së drejtës për të zgjedhur mbrojtësin nga i pandehuri te familjarët, por nënkupton edhe ushtrimin e vullnetit të këtij të pandehuri nëpërmjet familjarëve. Në qoftë se ka mospërputhje ndërmjet vullnetit të të pandehurit dhe vullnetit të familjarëve të tij, që kanë keqinterpretuar vullnetin e të pandehurit ose kanë pasur një vullnet të ndryshëm për mbrojtësin ligjor, duhet të mbizotërojnë vullneti i të pandehurit, i cili në çdo rast mund të refuzojë ose shkarkojë mbrojtësin e zgjedhur nga familjarët (*shih vendimin nr. 30, datë 17.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Ndërsa sipas vendimit nr.1/2014 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë i pandehuri lejohet gjithashtu të delegojë të drejtën për të bërë ankim te mbrojtësi, duke e ushtruar këtë vullnet nëpërmjet delegimit te një i afërm. I afërmi nuk zgjedh mbrojtës dhe as nuk delegon të drejtën për ankim në mënyrë autonome. Ankimi i mbrojtësit të zgjedhur nga të afërmit lejohet vetëm nëse provohet se (i) zgjedhja e mbrojtësit dhe (ii) delegimi i mbrojtësit për të ushtruar ankim është rezultat i vullnetit të plotë dhe eksplikit të titullarit të kësaj të drejte, që është i pandehuri.

24. Sipas nenit 48, pika 2, të KPP-së, zgjedhja e mbrojtësit bëhet me deklaram të bërë para organit procedues ose me akt të dhënë mbrojtësit ose të dërguar atij rekomandë, kurse sipas pikës 3 zgjedhja e mbrojtësit për personin e (...) arrestuar ose dënuar me burgim, derisa ky person nuk e ka bërë vetë zgjedhjen, mund të bëhet nga një i afërm i tij, në format e parashikuara nga paragrafi 2. Ndërsa neni 50, pika 1, parashikon se mbrojtësi ka të drejtat që ligji i njeh të pandehurit, përveç atyre që i rezervohen personalisht këtij të fundit. Neni 410 parashikon se i pandehuri mund të bëjë ankim vetë ose nëpërmjet mbrojtësit të tij.

25. Nga sa më sipër, Kolegji fillimisht evidenton se ankimi i mbrojtësit të caktuar nga familjarët është paraqitur në datën 14.10.2022, ndërsa ndaj kërkuesit është vendosur lirimi me kusht me vendimin e gjykatës së shtetit grek të datës 05.06.2020. Pra, nga të dhënat bashkëlidhur ankimit kushtetues, nuk rezulton që kërkuesi të ketë qenë në kushtet e heqjes së lirisë apo në ndonjë masë tjetër sigurie. Ndërkohë, gjykata e apelit është shprehur se nuk rezulton që kërkuesi të ketë

dhënë pëlqimin për mbrojtësin e caktuar nga familjari i tij apo që të ketë pasur komunikime mes tyre. Gjykata e Lartë e ka mbështetur këtë arsyetim për moslegjitimimin e mbrojtësit, por gjithashtu është shprehur edhe për shkaqet e rekursit.

26. Kolegji vëren se thelbi i pretendimit të kërkuarit lidhet me mënyrën se si gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë vlerësuar legjitimimin e mbrojtësit për ushtrimin e ankimit në emër të tij. Në këtë drejtim, Kolegji rithekson se interpretimi dhe zbatimi i ligjit procedural penal është atribut i gjykatave të zakonshme dhe nuk hyn në juridiksionin kushtetues, përveç rasteve kur interpretimi rezulton haptazi arbitrar ose cenon garancitë e procesit të rregullt ligjor. Në rastin konkret, gjykata e apelit ka arsyetuar se mbrojtësi nuk legjitimohej të ushtronte ankim në emër të kërkuarit, pasi prokura e posaçme mbi të cilën mbështetej ishte lëshuar nga familjarët e këtij të fundit dhe jo prej vetë kërkuarit, ndërsa nuk rezultonte të kishte prova që ai të kishte shprehur vullnetin ose të kishte autorizuar mbrojtësin për paraqitjen e ankimit. Ky arsyetim i është nënshtruar kontrollit edhe nga Gjykata e Lartë, e cila ka vlerësuar se mosplotësimi i këtij kriteri sjell mospranimin e ankimit. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se gjykatat kanë arsyetuar mjaftueshëm mbi mungesën e legjitimit të mbrojtësit dhe kanë mbështetur përfundimet e tyre në rrethanat e çështjes dhe në dispozitat procedurale penale. Në këtë kuptim, zbatimi i ligjit prej tyre nuk rezulton të ketë qenë arbitrar, në atë masë që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën e ankimit dhe standardin e arsyetimit të vendimit është haptazi i pabazuar.

27. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31, 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.